



Webinar rajonal për vendet candidate dhe vendet partnere të EAfA-së

Aleanca Evropiane për Praktikën Profesionale (EAfA) 19 Nëntor 2021

Ky eveniment ishte webinar i gjashtë rajonal i Fondacionit Evropian të Trajnimit (ETF) dhe Aleancës Evropiane për Praktikën Profesionale (EAfA) për të diskutuar zhvillimet e politikave dhe temat e ndryshme mbizotëruese mbi mësimin e bazuar në punë (WBL) në vendet candidate për anëtarësim në BE dhe vendet partnere të EAfA.

ZHVILLIMET E POLITIKËS SË BE-SË

Cesare Onestini, Drejtor i ETF, duke hapur këtë eveniment, përsëri ka konfirmuar përkushtimin e ETF për zhvillimin e mëtejshëm dhe sa më të mirë të praktikave duke mbështetur vendet candidate në miratimin dhe zbatimin e masave relevante. Progresi i dukshëm i bërë në vitet e fundit tregon rezultatet e këtij angazhimi.

Ana Carrero, Zëvendës Drejtuese e Njësisë në DG EMPL, ka prezantuar zhvillimet më të fundit të politikave në fushën e arsimit profesional. Duke vazhduar punën e specifikuar në përfundimet e Rigës të vitit 2015, Deklarata e Osnabrück-ut përcakton veprimet e politikave për periudhën 2021-2025 duke mbështetur Rekomandimin e Këshillit të BE-së për arsimin dhe trajnimin profesional (AFP) për konkurrencë të qëndrueshme, drejtësi sociale dhe qëndrueshmëri.

Tre vjet pas zbatimit të Rekomandimit të Këshillit të vitit 2018 mbi një Kuadër Evropian për Praktikën Cilësore dhe Efektive (EFQEA), një raport i Komisionit tregon se progresi i mëtejshëm është i nevojshme në zbatimin e kushteve kornizë, ndërsa shtatë kritere për të kushtet e të mësuarit dhe të punës janë të vendosura në shumicën e Shteteve Anëtare.

Tranzicioni i gjelbër dhe ai digjital janë në krye të agjendës politike të BE-së. Plani i Veprimit i përditësuar për Arsimin Digjital përcakton objektiva më ambicioze për zhvillimin e një ekosistemi arsimor digjital me performancë të lartë.

Nismat siç është mjeti SELFIE WBL gjithashtu janë zhvilluar për të ofruar mbështetje për vendet, shkollat dhe kompanitë që e ndjekin tranzicionin digjital.

Jasmina Poličnik, Sekretare në Drejtorinë e Arsimit të Lartë Profesional dhe të Arsimit të Lartë me Cikël të Shkurtër në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Sportit të Sllovenisë, ka prezantuar **prioritetet e Presidencës Sllovene**, duke përfshirë rinovimin e Agjendës Evropiane për Arsimimin e të Rriturve.

FINANCIMI PËR INTEGRIM RAJONAL

Neil Taylor, Drejtor i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në Kosovë* (BERZH), ka prezantuar mënyrën se si përdoren investimet për të mbështetur integrimin rajonal në Ballkanin Perëndimor. Në veçanti, investimet e sektorit privat (që përfaqësojnë rreth 65% të investimit të përgjithshëm të BERZH) mbështesin projektet që e stimulojnë tranzicionin drejt ekonomive të gjelbra të qëndrueshme. Hartimi i programeve të financimit duhet të marrë në konsideratë nevojat e grupeve vulnerable, si dhe kërkesat për aftësi. Janë krijuar partneritetet me punëdhënësit, bizneset dhe sektorët e trajnimit për të krijuar më shumë sinergji dhe për të arritur përputhje më të mirë të aftësive.

* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 dhe Opinionin e GjND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

MIRËSEARDHJA PËR SHTETET E REJA NË EAFA

Webinari ka ofruar një mundësi për të mirëpritur në Aleancë dy shtete të reja partnere të ETF, Izraelin dhe Moldavinë, duke treguar rritjen e vazhdueshme të komunitetit të palëve aktive të interesit dhe nga ana tjetër angazhimin për rritje dhe zgjerim të bashkëpunimit.





“Me anëtarësimin në Aleancë, ne synojmë të inkurajojmë zhvillimin dhe përcaktimin e më shumë praktikave për të ndihmuar qytetarët që të zhvillojnë aftësitë që përputhen me nevojat e tregut të punës.”

Nitzan Mimrod, Shef i Byrosë së Trajnimit Profesional dhe të Zhvillimit të Fuqisë Punëtore, Ministria e Ekonomisë dhe Industrisë së Shtetit të Izraelit.



EAFA përfaqëson një mundësi të madhe për të mësuar nga përvojat dhe praktikat më të mira të vendeve të tjera në Evropë.

Silviu Gîncu, Shef i Departamentit të AAP-së në Ministrinë e Arsimit dhe Kërkimit të Republikës të Moldavisë

Shqipëria

Ka filluar bashkëpunimi mes shkollave dhe bizneseve konform zbatimit të Rregullores së WBL, dhe po zhvillohet ngritja e kapaciteteve të koordinatorëve ndërlidhës.

Maqedonia e Veriut

Që nga viti 2019, WBL është implementuar plotësisht në Maqedoninë e Veriut. Zhvillimet e fundit për të përmirësuar WBL përfshijnë miratimin e një ligji të ri të AFP-së që sjellë elemente të reja që kanë të bëjnë me arsimin dual. Trajnimi i mentorëve dhe ngritja e kapaciteteve të koordinatorëve janë gjithashtu në vazhdim.

Mali i Zi

Mali i Zi ka parë rritje të qëndrueshme në numër të studentëve të AAP-së në vitet e fundit. Vendi është i gatshëm për të nisur një metodologji pilot për studentët, përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet shkollave dhe punëdhënësve, dhe trajnimin e mëtejshëm të mësuesve.

Serbia

Një video promovuese ka shfaqur mësimin praktik dhe mundësitë e menjëhershme për punësim pas AFP-së, që janë arsyt kryesore që mbështesin vlerësimin e WBL nga studentët në Serbi. Pavarësisht se paraqet një sfidë në kontekstin e WBL, mësimi në distancë i imponuar nga pandemia ka inkurajuar gjithashtu zhvillimin e qasjeve të reja digjitale në WBL.

Turqia

Turqia ka një WBL të zhvilluar mirë falë edhe partneritet të fuqishëm me sektorin privat. Në Turqi është zhvilluar një program i ri për Qendrat e Formimit Profesional. Ky program nxit integrimin e trajnimit praktik në kompanitë dhe arsimin teorik në shkollë. Programi synon që të përgatisë individët me aftësitë e nevojshme për profesionet e tyre të ardhshme, dhe pjesëmarrja në të çon në marrjen e certifikatave dhe diplomave përkatëse për usta dhe mjeshtri.

ZHVILLIMET E FUNDIT TË VENDEVE PARTNERE MBI MËSIMIN E BAZUAR NË PUNË DHE PRAKTIKAT

Krijimi i një kuadri ligjor për praktikën në përputhje me EFQEA është një parakusht për tu anëtarësuar në EAFA. Përfaqësuesit nga pesë vendet partnere që i janë bashkuar EAFA-s deri më tani kanë prezantuar zhvillimet më të fundit në vendosjen e WBL.

NE PRITJE TË 2022

Evenimenti i radhës i ETF-EAFA do të zhvillohet në Beograd, në vitin 2022. Evenimenti do të ofrojë një mundësi për të diskutuar mbi digjitalizimin në Vendet Kandidate dhe Partnere, dhe për përdorimin e fondeve të BE-së për projekte të përmirësimit digjital të AAP. Ndërsa viti 2022 është Viti Evropian i Rinisë, evenimenti gjithashtu do të përfshijë politikën dhe mjetet që po zhvillohen dhe që synojnë mbështetjen e të rinjve.

Pjesëmarrësit inkurajohen që të ndajnë të dhënat e veta me ETF për të formuar përmbajtjen e evenimentit të ardhshëm.

PLANI I VEPRIMIT I EAFA-S

Së shpejti do të publikohet Plani i Veprimit i EAFA-s për vitin e ardhshëm. Disa pika kryesore, të përmendura nga **Norbert Schoebel, DG EMPL**, kanë përfshirë:

- Evenimenti hibrid **'EAFA në rrugën e duhur'**, në bashkëpunim me Hekurudhat Federale Austriake (Vjenë, Mars 2022)
- **'Rinisja e EAN në kontekstin e Vitit Evropian të Rinisë'**, evenimenti hibrid në bashkëpunim me Fundación Bertelsmann dhe Generalitat de Catalunya (Barcelona, Mars 2022)
- **Bashkimi i EAFA-s**, evenimenti me ku do të takohemi personalisht (Bruksel, qershor 2022)

Në përputhje me prioritetet e EAFA-s dhe reagimet e anëtarëve, do të vazhdojnë aktivitetet siç janë webinarët dhe diskutimet e drejtpërdrejta, dhe ndërkohë do të prezantohen edhe aktivitetet e reja. Në vitin 2022, EAFA do të zhvillojë një seri të podcast-esh për të diskutuar praktikën dhe katër objektivat kryesore të EAFA-s. Zbuloni [këtu](#) planin e veprimit të EAFA-s për vitin 2022.

Gjeni më shumë informacione në lidhje me diskutimet e drejtpërdrejta të EAFA-s [këtu](#).

Bashkohuni me grupin tonë LinkedIn [këtu](#).
Regjistrohuni për të marrë buletin tremujor të EAFA:
Për anëtarët e EAFA, vetëm [këtu](#).
Për anëtarët që nuk janë në EAFA, [këtu](#).

#ApprenEU